

VENDIM
Nr. 539, datë 13.6 2013

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT TË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE
PRIVATE “ALDENT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 5, 40 e 43 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit të shkollës së lartë universitare private “Aldent”, nga shkollë e lartë universitare në universitet, me emërtimin universiteti “Aldent”.

2. Universiteti “Aldent” ruan akreditimin institucional dhe të programeve të studimit, të fituar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në këtë institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha